



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:047699
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05827574

C.nr.1796/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.V. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.H., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 909.36 euro, jashtë seancës, me datë 06.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit J.V. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kualifikimit master për periudhën Shkurt 2021 – Janar 2023, për 24 muaj, duke llogaritur diferencën në pagë të shumës së pagjykuar, nga 33.68 euro për çdo muaj, t’ia paguaj paditësit shumën prej 808.32 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 12.02.2024 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, e kërkuar për periudhën kohore Nëntor 2020 – Shkurt 2021, në shumën e përgjithshme prej 101.04 euro.

III. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj paditësit shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 12.02.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 909.36 euro.

Në padi ka theksuar se i njëjti është i punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Rexhep Elmazi” në Gjilan, në cilësinë e mësimitdhënësit, sipas kontratës së punës me kohë të pacaktuar. Ka shtuar se është i kualifikuar me nivel master, mirëpo me aktgjykimin e

kësaj gjykate C.nr.2473/2023 të datës 17.01.2024, përmes të cilit i është aprovuar kërkesa paditësit, të njëjtit i është kompensuar diferenca e papaguar e kualifikimit me nivel bachelor për periudhën kohore Nëntor 2020 – Janar 2023, për 27 muaj. Meqenëse paditësit me aktgjykimin e lartcekur i është njohur e drejta në kompensim prej 27 % të pagës bazë me kualifikim bachelor, me këtë kërkesëpadi ka kërkuar t'i njihet pjesa e pagjykuar me kualifikim master. Diferenca e përqindjes së papaguar ka theksuar se është 8 % (35 % e kualifikimit master – 27 % e kualifikimit bachelor), prandaj duke qenë se paditësit i është njohur e drejta në kompensim prej 55.35 euro, gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë edhe 33.68 euro për çdo muaj, për periudhën kohore Nëntor 2020 – Janar 2023, në shumën prej 909.36 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 20.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar e lidhur mes paditësit dhe të paditurës, e dt.01.09.2015 dhe vërtetimi nr.prot.649/2023 i dt.07.11.2023 i lëshuar nga SHFMU “Rexhep Elmazi”).

Nuk është kontestuese se e njëjti ka diplomë të nivelit Master nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.1292 e dt.06.06.2019), dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditësit nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Nuk është kontestuese se paditësit me aktgjykim të kësaj gjykate, C.nr.2473/2023 të datës 17.01.2024 i është njohur diferenca në pagë sipas kualifikimit bachelor për periudhën kohore Nëntor 2020 – Janar 2023, për 27 muaj, në shumën prej 1,494.45 euro, duke llogaritur shumën prej 55.35 euro për çdo muaj.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë Janar 2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se e paditura e ka pasur për obligim të kompensojë paditësin me 35 % të vlerës së pagës bazë për shkak të kualifikimit të tij me master, e cila vlerë arrin shumën prej 147.35 euro. E paditura ka kompensuar pjesërisht paditësin me shumën prej 58.32 euro në muaj, ashtu që i ka mbetur borxh paditësit për pjesën tjetër prej 89.03 euro në muaj. Nga pjesa e mbetur borxh, paditësit me aktgjykim të kësaj gjykate i është njohur edhe shuma prej 55.35 euro në muaj, ashtu që tani e tutje e paditura i ka mbetur borxh paditësit në shumën prej 33.68 euro në muaj (89.03 – 55.35).

Nga kjo arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që i njohi paditësit pjesën e diferencës së papaguar nga e paditura për periudhën që nuk është e përfshirë në parashkrim, ndërsa llogaritjen e diferencës, e bazoi në shumën e mbetur të borxhit nga e paditura, pra në lartësinë prej 33.68 euro në muaj.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Meqë e paditura është thirrë në parashkrim, gjykata gjeti se një pjesë e kërkesës së paditësit është e parashkruar duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës që përcakton se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjen zbatim neni 87 i LP-së, pasi kërkesa e paditësit është kërkesë monetare, e cila është paraqitur më datë 12.02.2024, ndërsa parashkruhet prej 3 vite nga data e paraqitjes së kërkesës, pra deri më Shkurt 2021. Nga kjo, gjykata gjen se kërkesa e paditësit është pjesërisht e përfshirë në parashkrim, pra pjesa e kërkuar nga Nëntor 2020 deri më Shkurt 2021.

Nga kjo arsye, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që i refuzoi paditësit pjesën e përfshirë në parashkrim të kërkesës.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1796/24, më datë 06.06.2024

Gjyqtari,
Berat Spahiu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate.